

Lëshimi i pasaportës biometrike për shtetasit nën 16 vjeç

Përshkrimi

Pajisja e shtetasve shqiptarë me pasaportë biometrike për jashtë shtetit, nën 16 vjeç.

Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Certifikatë familjare
- 2) Pasaportë e modelit të vjetër dhe/ose
- 3) Dokument tjetër i vlefshëm me fotografi lëshuar nga vendi pritës
- 4) Kuponi për pasaportën ose konferma për kryerjen e pagesës në llogarinë e përfaqësisë

Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja personale (shtetasi nën 16 vjeç shoqërohet të paktën nga njëri prind,ose nga kujdestari ligjor ose nga një përfaqësues i caktuar me prokurë të posaçme) dhe verifikimi i identitetit
- 2) Konfirmimi i të dhënave me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile;
- 3) Marrja e fotos dixhitale
- 4) Skanimi dhe marrja e shenjave të gishtërinjve
- 5) Depozitimi i nënshkrimit elektronik (nënshkruan prindi kur femija nuk mund të shkruajë)

Tarifa e shërbimit dhe afati

- 1) Greqi, Itali :130 euro,
- 2) Bruksel: 170 euro,
- 3) Angli: 144 paund,
- 4) Zvicër: 204 franga,
- 5) SHBA: 240\$

Afati i shërbimit është 28 ditë

Zyra

- 1) Ambasadat e RSH: Athinë; Romë; Londër; Bernë.
- 2) Konsullatat e Përgjithshme: Selanik; Milano.
- 3) Zyra konsullore: Nju Jork.

Shënime

Vlefshmëria e pasaportave është 5 vjet.

Tërheqja e pasaportës bëhet nga prindi ose nga kujdestari ligjor ose nga një përfaqësues i caktuar me prokurë të posaçme).